

## FJALA E DEPUTETES GERTA DURAKU E HËNË 23 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Dua të shfrytëzoj rastin që nga foltorja e Kuvendit t'u drejtohem banorëve të Kukësit, Hasit dhe të Tropojës. Të nderuar miq, Kam nderin e madh t'ju përfaqësoj e të përcjell në parlamentin shqiptar të gjitha shqetësimet tuaja, siç jam zotuar para 25 prillit. Për mua është fjala e parë në këtë sallë, ndaj do të doja të bëja një panoramë të qarkut tim në këta 30 vjet demokraci. Kukësin në këta 30 vjet, njëlloj si Shqipërinë, e kanë qeverisur jo vetëm dy parti, por dy filozofi të ndryshme. Historia dhe faktet flasin qartë për diferencën midis dy palëve. Unë do ndalem vetëm te faktet, si për problemet, ashtu edhe për punët e mira që janë bërë. Po e nis nga çfarë duhet bërë në vazhdim për Kukësin, Hasin dhe Tropojën, duke qenë se vij nga terreni dhe ballafaqimi me problemet e qytetarëve atje. Prioritet mbetet infrastruktura rrugore në shumë fshatra, pasi pa rrugë nuk ka zhvillim. Krahas punës së mirë që është bërë me investime dhe promovim, ky vizion duhet të vazhdojë. Në disa fshatra duhet akoma ndërhyrje në infrastrukturën rrugore për t'i afruar ato akoma më shumë me qytetin, për të lehtësuar transportin e produkteve të tyre dhe për të krijuar mandej pika të grumbullimit për këto produkte. Qeveria shqiptare në programin e saj ka pasur e ka mbështetjen me grante nga fondet e AZHBR-së për sektorët e bujqësisë dhe agroturizmit. Edhe qarku ynë ka përfituar nga këto fonde. Por ajo që dua të theksoj është sot se numri i përfituesve për vitin 2022 do të rritet dhe thirrja ime është që të gjithë individët apo subjektet bujqësore duhet të aplikojnë për fondet që u nevojiten për zhvillimin e pronës, të aktivitetit apo edhe të investimeve që programojnë të bëjnë në fushën e bujqësisë dhe të agroturizmit. Rrjedhimisht, paralel me këtë, mendoj që në qarkun tonë një rëndësi të madhe kanë edhe investimet në fshatrat turistike, sidomos në kthimin e ndërtesave ekzistuese në bujtina turistike, sipas kërkesave të kohës. Mbështetja në këtë sektor do të ulë papunësinë dhe do të rrisë numrin e turistëve. Infrastruktura rrugore, agroturizmi, mbështetja e vazhdueshme për bujqit e blegtorët janë nevoja që fshati i ka prioritare, ku, pavarësisht punës së bërë, ka akoma nevojë për mbështetje; kjo për sa i përket terrenit sot. Historia ka një të shkuar, e cila ka dy anë. Opozita e sotme gjatë qeverisjes së saj e ka trajtuar këtë qark vetëm si hambar votash dhe shumë pak janë bërë për të përmirësuar jetesën e këtyre banorëve. Edhe Rruga e Kombit, për të cilën krenohet opozita, mbetet një investim me shumë halle, projekt i papërfunduar dhe kudo ka nevojë për ndërhyrje. Po ju kujtoj se janë 230 milionë euro që kanë shkuar dëm, pa adresë dhe për të cilat ende nuk ka dhënë llogari askush. Por gjithçka ka ndryshuar për mirë me qeverisjen e Partisë Socialiste. Qytetarët janë vlerësuar. Pavarësisht se në nivel lokal Kukësi dhe Tropoja deri para dy vjetësh janë drejtuar nga opozita e sotme, Partia Socialiste nuk ndoqi kurrë parimin se cilit krah i përket kryetari i bashkisë. Gjatë këtyre vjetëve u bënë ndryshime të mëdha me "Rilindjen urbane". Tri qytetet tona, Kukësi, Bajram Curri dhe Kruma ishin lënë në mëshirë të fatit, por tani ka ndryshuar gjithçka. Në Kukës tani funksionon një aeroport modern, së shpejti do të ketë një spital rajonal tepër cilësor dhe një stadium bashkëkohor, pa harruar edhe Skavicën, projektin historik që do të punësojë me qindra banorë. Këto janë fakte që ua kanë ndryshuar jetën atyre njerëzve. Dua t'i garantoj të gjithë qytetarët e Kukësit,

Hasit dhe Tropojës se do të jem në vijën e parë për të kërkuar mbështetjen e qeverisë për programet e iniciativat që ndihmojnë zhvillimin dhe mirëqenien e banorëve të qarkut tonë. Faleminderit!